

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Davor Macura, shtetas i Republikës së Serbisë, XXX, i dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokatëve Ruzhojçiq nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 18.03.2026, mori këtë:

### **AKTVENDIM**

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin Davor Macura, XXX, do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë individual mbi Shoqërinë Aksionare për Sigurime ZOIL Maqedonia, Manastir, me seli të regjistruar në rrugën Prilepska nr. 1/2/1, përdhese – Kom.Pel. 1, Manastir, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

### **A r s y e t i m**

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 16.02.2026, e plotësuar më 25.02.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftim për përqendrim nga Davor Macura, shtetas i Republikës së Serbisë, XXX, me të cilin Davor Macura do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë individual mbi Shoqërinë Aksionare për Sigurime ZOIL Maqedonia, Manastir, me seli të regjistruar në rrugën Prilepska nr. 1/2/1, përdhese – Kom.Pel. 1, Manastir, përmes blerjes së aksioneve.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, konstatoi sa vijon:

## **Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira**

**Davor Macura** është person fizik, i cili është pronari përfundimtar i Alta Group, kompani holding e specializuar në ofrimin e shërbimeve të pagesave, e cila operon në tregun serb me rrjetin më të madh të pikave të pagesës. Ajo është kompania mëmë që bashkon, ndër të tjera, shoqëritë e lidhura Alta Banka a.d. Beograd dhe PROKOOPAK d.o.o. Beograd, kompani me seli në Beograd dhe e regjistruar për ndërtimin e objekteve banesore dhe jo banesore. Veprimtaritë kryesore të Alta Banka Beograd janë kryerja e transaksioneve të pagesave brenda dhe jashtë vendit, operacionet kreditore, operacionet e depozitave dhe tregtimi i valutave të huaja. Aktivitetet e tjera përfshijnë lëshimin e garancive, hapjen e akreditivave dhe operacione të tjera bankare. Aksioneri i vetëm i Alta Banka Beograd është Alta Group.

Filiali i Alta Banka Beograd, Alta Leasing, ofron një portofol të gjerë shërbimesh financimi për blerjen e automjeteve të pasagjerëve dhe automjeteve të lehta komerciale, pajisjeve dhe makinerive të ndryshme të nevojshme në sektorë të ndryshëm industrialë, si dhe mekanizim dhe pajisje të specializuara bujqësore.

Davor Macura dhe shoqëritë e tij të lidhura janë të pranishme në Maqedoninë e Veriut përmes ALTA BANKA A.D. MANASTIR, me seli në rr. Dobrivoje Radosavljeviq nr. 21, Manastir.

ALTA BANKA A.D. Manastir ka një histori të gjatë të aktivitetit afarist dhe pranisë në fushën e shërbimeve financiare, duke përfshirë grumbullimin e depozitave, miratimin e kredive, qarkullimin pagesor, bankimin elektronik dhe aktivitete të tjera shoqëruese bankare. ALTA BANKA A.D. MANASTIR ka personat e mëposhtëm të lidhur të regjistruar në Maqedoninë e Veriut:

ODA EKONOMIKE AMERIKANE NË MAQEDONINË E VERIUT, Bashkësi e Interesit Ekonomik, me seli në rr. Maksim Gorki nr. 11, Shkup, me veprimtari prioritare – veprimtari të organizatave të tjera mbi bazën e anëtarësimit, të pa përfshira diku tjetër;

Shoqata për realizimin e interesave të përbashkëta të bankave dhe avancimin e veprimtarisë së tyre – ASOCIACIONI BANKAR I MAQEDONISË, Shkup, me seli në rr. Orce Nikollov nr. 75, Shkup, me veprimtari prioritare – veprimtari të organizatave të tjera mbi bazën e anëtarësimit, të pa përfshira diku tjetër; dhe

Shoqëria për Tregti dhe Shërbime PELAGONIJA FINANCE SHPK Shkup – në likuidim, me seli në rr. Maqedonia nr. 38, Shkup, me veprimtari prioritare – veprimtari menaxhuese.

**Shoqëria Aksionare për Sigurime ZOIL Maqedonia, Manastir** ofron shërbime të sigurimit jo jetësor në Maqedoninë e Veriut. Ajo ushtron veprimtari të sigurimit jo jetësor, përkatësisht sigurim nga aksidentet, sigurim shëndetësor, sigurim gjithëpërfshirës të automjeteve motorike, sigurim përgjegjësie etj.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të

konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.  
Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

**Udhëzim për mjetin juridik:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS  
KRYETARE**

**Mr. Малинка Силјановска Николиќ**